

Thirrja është e hapur nga data 10.07.05.2026 deri me 15.07.2026

TERMAT E REFERENCËS

HOTELE/ RESTAURANTE NË KOMUNËN E MITROVICËS SË JUGUT TË CILËT OFROJNË SHËRBIME PËR REALIZIMIN E AKTIVITETEVE TË ORGANIZATËS NEVO KONCEPTI

Organizata	OJQ "NEVO KONCEPTI"
Objektiva	Përzgjedhja e hotelit/restaurantit në Komunën e Mitrovicës së Jugut për ofrimin e shërbimeve të sallës së konferencave, ushqimit dhe pijeve për zhvillimin e aktiviteteve të organizuara nga OJQ "Nevo Koncepti".

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ "Nevo Koncepti" është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ "Nevo Koncepti" kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ "Nevo Koncepti" bashkëpunon me fëmije, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

Aktualisht OJQ "Nevo Koncepti" është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

2. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Mirëpritja e stafit dhe antarëve të cilët do të marrin pjesë në aktivitetin të cilin do të zhvillohet në Restuarant/Hotel.
- Përgaditja e ushqimit sipas kërkesës, nga ana përfaqësuesve të OJQ "Nevo Konceptit".
- Salla e takimeve të plotësojë kushtet për zhvillimin e takimeve, trajnimeve dhe konferencave.
- Përgatitja e faturës me kohë dhe pritshmëria e pagesës përmes transferit bankar.
- Zbritja e TVSH-së në faturim bazuar në dokumentin e ofruar nga OJQ "Nevo Koncepti" e cila lirohet nga TVSH-ja në bazë të UA Nr.03/2015 për TVSH

3. AFATI KOHOR

Njoftimi i përfaqësuesve të restaurantit/hotelit për zhvillimin e aktiviteteve të caktuara do të jetë dy ditë më parë para zhvillimit të aktivitetit për shkak të përgaditjes.

5. REZULTATET E PRITSHME

- Të sigurojë mirëpritjen e stafit dhe pjesëmarrësve që do të marrin pjesë në aktivitetet e organizuara nga OJQ "Nevo Koncepti".
- Të përgatisë ushqimin sipas kërkesave të përcaktuara nga përfaqësuesit e OJQ "Nevo Koncepti".
- Të ofrojë sallë që i plotëson kushtet e nevojshme për zhvillimin e takimeve, trajnimeve dhe konferencave.
- Të lëshojë faturën në kohë, ndërsa pagesa do të realizohet përmes transferit bankar.
- Të lëshojë faturë pa TVSH, bazuar në dokumentin e lirim të TVSH që do të ofrohet nga OJQ "Nevo Koncepti", në përputhje me UA Nr. 03/2015 për TVSH.

PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet t'i dërgojnë këto dokumente:

- Kërkesa për ofertë (të jetë e nënshkruar dhe e vulosur)
- Oferta (të jetë e nënshkruar dhe e vulosur dhe çmimet të ofrohen pa TVSH)
- Kopja e dokumentit të ARBK-së së biznesit.

Aplikimi duhet të dërgohet jo më larg se data 15.07.2026 në emailin: prokurimi@nevokoncepti.org apo në formë fizike në selinë e OJQ "Nevo Koncepti" në adresën Rr. Adnan Krasniqi nr.149, hyrja II Nr.8 Prizren.